

PJESA B KONTRATA

KUVENDI I KOMUNES DRAGASHI, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; dhe

"U-Unique" Sh.p.k-Prishtine, (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), ne anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

Renovimi dhe sanimi i oborrit të shkollës fillore në Llopushnik (RITENDERIM) me numër Identifikues 621-20-7146-2-3-6, dhe nr, te mbrendshem 621-2020-160-236

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë **Renovimi dhe sanimi i oborrit të shkollës fillore në Llopushnik (RITENDERIM)**

1.2 Kontrata hynë në fuqi me **24.11.2020**, dhe përfundon me **23.12.2020**.

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se **1 ditë** nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i [ekzekutimit të punëve] do të jetë **shkolla fillore ne Llopushnik-Brezne-K.k. Dragash**

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

1.6 Menagjer i kontrates nga AK eshte: Vloran Cenaj

Menagjer i projektit nga AK eshte: Florim Krasniqi

Menagjer i projektit nga OE eshte: Ulpian Tahiri

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **9,458.30 €**; (*nente mij e katerqind e pesedhjetë e tete Euro e tridhjetë cent*).

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i *[punëve]* duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të *[punëve]*.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin *[te kryej ndonjë ose të gjitha punët]* brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve

tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së [punëve] të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paafësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykata Themelore në Prizren, dega në Dragash në pajtim me ligjin e Kosovës.




Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën [Shqip] [Serbisht] [Anglisht]² në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	“ U-Unique” Sh.p.k- Prishtine	Emri:	Nuro Ismaili
Pozita:	<i>menaqjer</i>	Pozita:	<i>160 Ri</i> <i>Zyrtar pergjegjes per prokurim</i>
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	24.11.2020	Data:	24.11.2020.
Vula:		Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.


Shkollë - Hlopushnik

U-Unique

PARAMASA DHE PARALLOGARIA PER PTOJEKTIN:					
Renovimi dhe sanimi i oborrit te shkolles ne Llopushnik - RITENDERIM					
A	OBORRI				
SHFMU SHABAN SHABANI - LLAPUSHNIKË					
1	Punët Parapregaditore	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi i tërë
Të gjitha punët në përputhje me normat teknike dhe standardet Europiane dhe Eurokodit , Kompania punë kryese është përgjegjëse për ti marrë masat mbrojtëse dhe të siguroj punishten me mjetet sinjalizuese para fillimit të punët, në gjithë zonën ku do të zhvilloj aktivitetet e saj. Çdo dëmtim të instalimeve nëntoksore të qytetarve është e obliguar ti kthejë në gjendje të mëparshme me kosto të vetën financiare					
1.1	Shënimi i kantierit me shenja rreziku në zonat ku do të punohet te pllatoja e oborrit të shkollës sipas projektit detal ,gjatë kohës sa zgjatin punimet .Llog në m2	m2	600.00	0.10 €	60.00 €
1.2	Punët parapërgatitore, shënimi i pllato së oborrit ku do të vendosen kubëzat, sipërfaqet e gjelbruara , parkingjet , si dhe trajtimi i rrugës në hyrjedhe dalje në oborr të shkollës në raport me rrugën kryesore (Prizren- Dragash) në bazë të projektit zbatues,në matjet gjeodezike të përfshihen të gjitha punët e përmendura në kushtet e përgjithshme dhe teknike,Llog në m2	m2	889.00	0.10 €	88.90 €
1.3	Identifikimi i instalimeve nëntoksor dhe mbitoksorë (ujesjelles, kanalizimi, instalimet rrymes, instalimet telefonise dhe internetit), piketimi dhe regjistrimi në ditarin ndërtimor, me qëllim të evitimit parandalimit dëmtimeve eventuale mund të ndikojë në rrezikimin e personelit. Në këtë pozicion përfshihet edhe plani i situacionit të rrjetit ekzistues me qëllim që të hartohet plani i veprimit për shkyqje dhe demolim të rrjetit ekzistues pastrimin e terenit dhe pregaditjen e kushteve teknike të përgjithshme për ndërtimin e pllato së për vendosjen e kubëzave në SHFMU Shaban Shabaní . Llog m2	m2	889.00	0.10 €	88.90 €
	Gjithsej: Punët Parapregaditore				237.80 €
2	Punët e pastrimit dhe demolimit	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi i tërë
2.1	Pastrimi i terenit nga mbeturinat,e ngurta, materialet inerte , shkurre-drunjë ,në hapsirën me qëllim të lirit të hapsirës për kubëzimin e pllato së Oborrit Shkollës,Materiali i demoluar Deponimin e materialit të demoluar e cakton Investitori.. Në këtë pozicion përfshihet edhe demolimi i rethojave për siguri dhe mbrojtje në punë si dhe kthimin në gjendje të mëparshme pas përfundimit të punimeve. Llog .në m².	m2	889.00	0.10 €	88.90 €
	Gjithsej: Punët e demolimit				88.90 €



3	Punët Tokësore	Njësi	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi i tërë
3.1	Gërryerja ,gërmimi dhe largimi i dheut të kat III -V Me makina ndertimore në vendet e projektuara për nivelizimin dhe zgjerimin dhe rregullimin e pllatores së oborrit të shkollës me trashësi t = 20 deri ne 40 cm . Në këtë pozicion përfshihet edhe nivelizimi terenit me ramjet e dhura duke përfshi edhe elementet tjera përcjellëse të përcaktuar në projekt sipas kushteve teknike dhe përgjithshme , si dhe detaleve teknike . Largimi i dheut te germuar ne deponin te cilen e cakton investitori Llog m3 me të gjitha shpenzimet.				
	Gërmimi me makineri (88%)	m3	120	1.00 €	120.00 €
	Gërmimi me dorë (10%)	m3	18	1.00 €	18.00 €
	Gërmimi me çekanë (2%)	m3	3.6	1.00 €	3.60 €
	Planifikimi dhe punimi i bazamentit të oborrit , stazave për ecje dhe parkingjeve	m2	600	0.10 €	60.00 €
	Gjithsej: Punët e dheut				201.60 €
4	Pjesa sipërme (Mbushja) pllatores oborrit	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi i tërë
4.1	Furnizimi, transporti, shtrirja nivelizimi ngjeshja dhe punimi i shtresës së nën bazës së pllatores së oborrit, stazave për ecje dhe parkingjeve nga materiali guror ,Fraksion (0 deri 64) mm me trashësi të shtresës t=20 cm si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes Mv=250 kg/cm2 . Materiali i përdorur duhet te jete i paisur me ateste paraprake ,dhe ate sipas normave dhe standardeve. Vrejtje : Pas përfundimit të kësaj shtrese kompania punëkyrese është e obliguar ta shqyrtoj testin e modulit të ngjeshjes dhe ta prezentoj tek menaxheri kontratës.				
	Furnizimi dhe punimi i bazamentit me gurë natyral	m3	120.00	2.00 €	240.00 €
4.2	Furnizimi, transporti, shtrirja,nivelizimi i bazes dhe punimi i bazës së pllatores së oborrit, stazave për ecje dhe parkingjeve me materialin guror nga gurit të thyer fraksion(0-32) mm, me trashësi të shtresës t=10 cm si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues.Materiali i përdorur duhet te jete i paisur me ateste paraprake ,dhe ate sipas normave dhe standardeve.Ngjeshja deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes Mv=400 kg/cm2 . Vrejtje : Pas përfundimit të kësaj shtrese kompania punëkyrese është e obliguar ta shqyrtoj testin e modulit të ngjeshjes dhe ta prezentoj tek menaxheri kontratës.				
	Furnizimi dhe punimi i shtresës me gurë të thyer fraksion 0-16 mm,t=10 cm	m3	60.00	4.00 €	240.00 €
4.2	Furnizimi, transporti, shtrirja,nivelizimi i bazes dhe punimi i bazës së pllatores së oborrit, stazave për ecje dhe parkingjeve me materialin guror nga gurit të thyer fraksion(0-16) mm, me trashësi të shtresës t=10 cm si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues.Materiali i përdorur duhet te jete i paisur me ateste paraprake ,dhe ate sipas normave dhe standardeve.Ngjeshja deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes Mv=300 kg/cm2 . Vrejtje : Pas përfundimit të kësaj shtrese kompania punëkyrese është e obliguar ta shqyrtoj testin e modulit të ngjeshjes dhe ta prezentoj tek menaxheri kontratës.				
	Furnizimi dhe punimi i shtresës me gurë të thyer fraksion 0-16 mm,t=10 cm	m3	60.00	4.00 €	240.00 €
4.3	Furnizimi, transporti, shtrirja dhe punimi i shtresës rrafshuese me rëre te imet nga gurit të thyer fraksion 0-4mm, me trashësi të shtresës t=5 cm si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes Mv=500 kg/cm2 . Sqarim : Pas përfundimit të kësaj shtrese kompani punëkyrese është e obliguar ta shqyrtoj testin moduli të ngjeshjes dhe ta prezentoj tek menaxheri kontratës.				
	Furnizimi dhe punimi i shtresës rrugëve me gurë të thyer fraksion 0-4 mm t= 5 cm	m3	30.00	4.00 €	120.00 €
	Gjithsej: Punët e pjesës sipërme (Mbushja) pllatores oborrit				840.00 €



5	Punët me elemente betono montuese	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi i tërë
5.2	Furnizimi, transporti dhe montimi i elementeve nga betoni, llogaritur te gjitha punimet e nevojshme, nga betoni I klasit C 30/37 , d-8cm forma e gjeometris së kubëzave ,kompetenc e percaktuar nga Investitori.Në çmim të parashifet edhe Furnizimi,transporti dhe shperndarja e reres (filerit) per mbushjen e fugave ne sipërfaqen e cila eshte e kubëzuar				
	Furnizimi,transporti dhe montimi i kubëzave	m2	600	11.50 €	6,900.00 €
	Furnizimi dhe montimi i skajoreve nga betoni C-30/37 dim.(10x24) cm, me baze betoni llogaritur me te gjitha punimet e tjera te nevojshme.	m'	220	4.50 €	990.00 €
	Furnizimi,transporti dhe montimi i rigolave nga betoni C 30/37, duke i llogaritur te gjitha punimet e tjera te nevojshme.paraprake	m'	20	10.00 €	200.00 €
	Gjithsej: Punët betono montuese:				8,090.00 €
REKAPITULIMI I PUNIMEVE PËR RREGULLIMI E OBORRIT - PËLATOSË SHITIGJEVE TË ECJES DHE PARKINGJEVE ME KUBËZA BETONI					
1	Punët Parapregaditore				237.80 €
2	Punët demoluese				88.90 €
3	Punët Tokësore				201.60 €
4	Pjesa sipërme (Mbushja) pllatos së oborrit				840.00 €
5	Punët e betono montuese				8,090.00 €
	TOTALI ME TVSH				9,458.30 €

